



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:117381

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05731897

KE.nr.113/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen juridike të paditësit NNSH “Agimi Komerce”, me seli në Mitrovicë, rr. “Ulqinit”, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shefqet Ibrahim, avokat nga Skenderaj, kundër të paditurit Byroja Kosovare e Sigurimeve, me seli në Prishtinë, rr. “Lidhja e Pejës”, p.n. Magjistratja Prishtinë – Pejë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A.I., me objekt kontesti, kompensimi dëmi – fitim i humbur, vlera e kontestit 20,774.90€, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik të datës 16.05.2023, në prezencë të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, me datën 24.05.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit NNSH “Agimi Komerce”, dhe DETYROHET i padituri Byroja Kosovare e Sigurimeve që në emër të kompensimit të dëmit– fitimit të humbur për periudhën e pamundësisë së përdorimit të automjetit “Mercedes” tipi 905 me tabela ..., për 22 ditë pune, t’ia paguaj paditësit shumën prej 2,002.40€ (dy mijë e dy euro e dyzet cent) me kamatë ligjore prej 8% nga data e paraqitjes së padisë, me datë 23.03.2016 deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi.
- II. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit NNSH “Agimi Komerce”, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri Byroja Kosovare e Sigurimeve, që në emër të kompensimit të dëmit – fitimi i humbur për periudhën e pamundësisë së përdorimit të automjetit “Mercedes” tipi 905 me tabela ... nga data 02.04.2015 deri më datën 20.01.2016 t’ia paguaj paditësit shumën prej 18,772.50€ (tetëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e dy euro e pesëdhjetë cent) me kamatë ligjore prej 8% nga data e paraqitjes së padisë, me datë 23.03.2016 e deri në pagesën definitive.

III. OBLIGOHET i padituri që në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi, në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t'ia kompensoj paditësit shumën prej 1,482.20€ (njëmijë e katërqind e tetëdhjetë e dy euro e njëzet cent).

A r s y e t i m

1. Çështja gjyqësore dhe pretendimet e palëve

Paditësi NNSH “Agimi Komerce” me datën 23.03.2016, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, ka paraqitur padi ndaj të paditurit Byroja Kosovare e Sigurimeve lidhur me kompensimin e dëmit të shkaktuar si pasojë e aksidentit të shkaktuar me datë 01.04.2015, ku paditësi ishte dëmtuar materialisht pasi që derisa ishte duke drejtuar me automjetin e vet transportues të markës “Mercedes” tipi 905 me tabela ..., ishte goditur nga automjeti i udhëtarëve me tabela të regjistrimit ..., pa policë të sigurimit dhe të pa regjistruar, të cilin ka qenë duke e drejtuar V.R.. Lidhur me dëmin material të shkaktuar si pasojë e këtij aksidenti, paditësi thekson se është kompensuar nga i padituri për dëmin e pësuar në automjetin transportues, mirëpo nuk i është kompensuar fitimi i humbur, ngase paditësi është regjistruar si ndërmarrës dhe se afarizmi i tij e ka transportin e mallrave, ndërkaq vlerën për fitimin e humbur e ka dhënë shumë të ulët e cila nuk është as e përafërt me atë që paditësi ka humbur deri sa automjeti ka mundur të shfrytëzohet përsëri.

Gjatë shqyrtimeve gjyqësore në rigjykim, përfaqësuesi i paditësit ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë padisë duke shtuar se nga provat e administruara është vërtetuar në tërësi gjendja faktike dhe gjatë fjalës përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë fjalës përfundimtare të paraqitur më datë 14.12.2018 duke shtuar se gjykata duke vepruar sipas aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë, janë nxjerr provat me të cilat është vërtetuar në tërësi baza e kërkesëpadisë në lartësi prej 20,774.90 euro, në emër të fitimit të humbur, se bashku me kumatën ligjore prej 8 % e cila do të llogaritet nga data e paraqitjes së padisë me datë 23.03.2016 deri në pagesën definitive. Më tej ka theksuar se deri tek shuma prej 20,774.90€ ka ardhur sipas ekspertizës financiare me të cilën konstatohet se paditësit i është shkaktuar kjo humbje si pasojë e pa mundësisë së shfrytëzimit të automjetit. Gjykatës i ka propozuar që të aprovoj padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të bazuar dhe të obligoj të paditurin që të paguaj shumën prej 20,774.90€ me kumatë ligjore prej 8 % nga data e paraqitjes së padisë deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet procedurale dhe atë për padi shumën prej 156.00€, për taksë shumën prej 15.00€, për ekspertizë financiare shumën prej 150.00€, për ekspertizë të makinerisë shumën prej 200.00€, për plotësim të ekspertizës financiare shumën prej 150.00€, për tri seanca në

Gjykatën Themelore në Prishtinë –Departamenti për Çështje Ekonomike shumë prej 250.00€ si dhe për tri seanca të mbajtura në Gjykatën Komerciale në shumë prej 250.00€, apo në shumë e përgjithshme prej 3,109.00€.

I padituri përmes përgjigjes në padi ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia, pasi që sipas të paditurit, për faktin se nga provat e prezantuara me padi nuk vërtetohet baza e kërkesëpadisë për pranimin e përgjegjësisë për dëmshpërblim nga ana e të paditurit. Tutje thekson se pala paditëse nuk ka ofruar prova të mjaftueshme si libri i kontabilitetit me të cilin janë konstatuar hyrje – daljet e të ardhurave, dëshmi se për sa kohë ka qëndruar automjeti në riparim. Duke konsideruar se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar i ka propozuar gjykatës që të njëjtën ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Gjatë shqyrtimeve gjyqësore në rigjykim, i padituri përmes përfaqësuesit të autorizuar ka deklaruar se mbetet në tërësi pran përgjigjes në padi, deklarimeve të thëna gjatë shqyrtimit gjyqësor duke kundërshtuar plotësisht bazën juridike të kërkesëpadisë. Ka theksuar se bazuar në nenin 4 të Ujdisë Jashtëgjyqësore, paditësi ka hequr dorë nga e drejta për kompensim shtesë material edhe po që se paraqiten pasoja tjera, përveç atyre që janë të përfshira në këtë marrëveshje që në këtë rast mund të jetë fitim i humbur eventual. Sa i përket dëmit të pretenduar sipas të paditurit, kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar dhe e njëjta duhet të refuzohet si e pabazuar sepse nuk provohet me siguri se paditësi ka pësuar dëm material në formën e fitimit të humbur.

Lidhur me këtë çështje kontestimore ishte vendosur edhe më parë nga Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, përmes Aktgjykimit III.Ek.nr.190/2017, të datës 26.12.2018 me të cilin ishte aprovuar në tërësi kërkesëpadia e paditësit si e bazuar, mirëpo ky aktgjykim ishte anuluar nga Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit Ae.nr.46/19 të datës 06.08.2020, me të cilin çështja ishte kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje.

2. Provat e administruara dhe gjendja faktike e vërtetuar

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore dhe në bazë të propozimeve të palëve ndërgjyqëse, gjykata në rigjykim gjatë procedurës së provave bëri administrimin e këtyre provave: Raporti i aksidentit me numër 2015-ST-023 e datës 01.04.2015 së bashku me skica, Certifikata e biznesit me nr. 80039905 dhe informatat e biznesit, Polica e sigurimit Iliria me nr. 0005362766, Certifikata me nr. fiskal 600225280, Certifikatë e TVSH nr.330016817, Libreza e veturës ..., Shkresa elektronike e dt. 20.05.2015, Vendimi me nr. FK

396/15 e datës 24.12.2015, Licencë e lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës e dt. 30.03.2015, Certifikata e automjetit transportues 01.04.2015, DUD i datës 04.03.2015, 05.03.2015, 06.03.2015, 06.03.2015. 17.03.2015. 13.02.2015, 19.03.2015, 23.03.2015, 25.03.2015, 28.03.2015, 04.04.2015, 08.04.2015, 10.04.2015, 18.04.2015, 18.04.2015, 25.04.2015, 06.05.2015, 08.05.2015, 09.05.2015, 11.05.2015, 16.05.2015, 30.05.2015, 03.06.2015, Ankesë e datës 30.07.2015, Vërtetim mbi servisimin e kamionit ACTR i datës 18.10.2018, Faturë numër 0412 i datës 26.09.2015, Ujdia jashtëgjyqësore e datës 29.12.2015 dhe Urdhërtransferi i datës 25.02.2016, Ekspertiza Financiare e hartuar nga eksperti financiar R.B. me datë 03.12.2018, Plotësimi i ekspertizës financiare i datës 18.02.2021 dhe Ekspertiza e makinerisë e hartuar nga eksperti S.B. e datës 20.01.2020.

Gjykata pas vlerësimit të deklarimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka konstatuar këtë gjendje faktike.

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se me datën 01.04.2015 paditësi kishte pësuar aksident trafiku, ku automjeti transportues “Mercedes” i tipit 905 me tabela ..., ishte goditur nga automjeti i udhëtarëve me tabela të regjistrimit ..., pa policë të sigurimit dhe të pa regjistruar, të cilin ka qenë duke e drejtuar V.R. siç konstatohet në raportin e aksidentit 2015-ST-023 të datës 01.04.2015.

Po ashtu, midis palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues shkaktimi i dëmit material në automjetin transportues dhe kompensimi i dëmit në shumë prej 6,663.00€ nga i padituri sipas Ujdisë Jashtëgjyqësore të datës 29.12.2015, dhe urdhërtransferit të datës 25.02.2016 në shumë prej 6,663.00€.

Për vërtetimin e pretendimeve të paditësit lidhur kohën e nevojshme për riparimin e automjetit të dëmtuar, gjykata me aktvendimin e datës 19.01.2021 ka nxjerrë provën përmes ekspertizës nga lëmia e makinerisë, e cila ekspertizë është hartuar nga eksperti S.B., me datë 20.01.2021, nga e cila gjykata ka konstatuar se koha e nevojshme për riparimin e automjetit të paditësit ka qenë 22 ditë pune apo 1 muaj mesatar i vitit. Në seancën e datës 03.05.2024 eksperti po ashtu ka theksuar se gjatë llogaritjes së kohës së nevojshme për riparimin e automjetit ka bërë llogaritjen duke në bazë të analizës për servisim në kushte normale pa llogaritur që mund të ketë të tjera automjete pra analiza është bërë në bazë shkencore dhe se nuk e din arsyen se pse automjeti ka qëndruar në auto-servis në kohëzgjatje prej rreth 9 muaj.

Gjykata në këtë çështje me aktvendimin e marrë me datë 27.04.2018 ka nxjerrë provën përmes ekspertizës nga lëmia financiare dhe për ekspert ka caktuar R.B. i cili me datë 03.12.2018 ka hartuar raportin e ekspertizës ndërsa sipas aktvendimit të datës 01.02.2021, me datë 18.02.2021 ka bërë plotësimin e ekspertizës financiare, në të cilin ka vlerësuar se paditësi për shkak të pamundësisë së shfrytëzimit të automjetit transportues për shërbimet e transportit si pasojë e riparimit për shkak të aksidentit i cili ka zgjatur nga 02.04.2015 deri më 20.01.2016 rrjedh se fitimi i humbur është 20.774.90€, ndërsa nëse llogaritja bëhet sipas ditëve të nevojshme për riparimin e veturës të konstatuara në ekspertizën e makinerisë, eksperti financiar ka vlerësuar se fitimi i munguar për 22 ditë pune apo 1 muaj mesatar i vitit është 2,002.40€.

Nga Vërtetim mbi servisimin e kamionit ACTROS i datës 18.10.2018, gjykata konstatoi se automjeti i paditësit është dërguar në servis me datë 02.04.2015 dhe ka dal nga servisi me datë 20.01.2016. .

Nga Licencë e lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës e dt. 30.03.2015, gjykata konstatoi se paditësi posedonte licencë për transportin rrugorë, ndërkombëtarë të mallrave.

Nga Vendimi me nr. FK 396/15 e datës 24.12.2015, gjykata ka konstatuar se i padituri pasi ka shqyrtuar kërkesën e paditësit për kompensimin e fitimit të humbur, ka miratuar kërkesën e paditësit për fitim të humbur në shumë prej 900.00€

Nga Dokumentet Unike Doganore të datës 04.03.2015, 05.03.2015, 06.03.2015, 06.03.2015, 17.03.2015, 13.02.2015, 19.03.2015, 23.03.2015, 25.03.2015, 28.03.2015, 04.04.2015, 08.04.2015, 10.04.2015, 18.04.2015, 18.04.2015, 25.04.2015, 06.05.2015, 08.05.2015, 09.05.2015, 11.05.2015, 16.05.2015, 30.05.2015, 03.06.2015, gjykata ka konstatuar se paditësi gjatë periudhës 04.03.2015 deri 03.06.2015 ka realizuar transporte të mallrave dhe atë sipas DUD të datës 06.03.2015, 17.03.2015, 23.03.2015, 25.03.2015, 28.03.2015, transportin e ka realizuar përmes automjetit transportues me targa ..., ndërsa pas aksidentit të datës 01.04.2015, transportin e ka realizuar me automjete tjera transportuese. Po ashtu gjykata ka konstatuar se edhe para aksidentit të datës 01.04.2015 paditësi ka përdorur edhe automjetet tjera transportues përveç automjetit të aksidentuar.

3. *Baza ligjore*

Nga faktet e vërtetuara, Gjykata gjeti se në rastin konkret gjejnë zbatim dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia dhe Ligjit Nr. 04/L-077 për

Marrëdhëniet e Detyrimeve të cilat ligje kanë qenë në fuqi në kohën e shkaktimit të dëmit dhe krijimit të raportit detyrimor në mes të palëve ndërgjyqëse.

Neni 9, par.1, pika 1.1 i Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia përcakton se: *“Sigurimi nga autopërgjegjësia mbulon: 1.1. dëmet në persona dhe pasuri të shkaktuara palëve të treta nga përdorimi i mjetit motorik.”*, neni përcakton se: *“Kompensimi i dëmit material dhe jomaterial bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve.”*

Si dhe neni 18 i këtij ligji parasheh se: *“1. Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësise, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja.”*

Ndërkaq në përputhje me nenin 136 par.1 të Ligjit për Marrëdhënia të Detyrimit, është përcaktuar se: *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij.”* ndërsa me nenin 137 të po këtij ligji është përcaktuar se: *“Dëmi është zvogëlim i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)”*.

Po ashtu me nenin 159 par.1 të LMD-së është përcaktuar se: *“Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjete motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi, zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit”*, kurse në nenin 173 përcaktohet se: *“1. I dëmtuari ka të drejtë si për shpërblimin e dëmit të rëndomtë, ashtu edhe për shpërblimin e fitimit të humbur.”*, si dhe neni 169 par 1. të LMD-së, i cili përcakton se: *“1. Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi.”*

Sa i përket kamatës ligjore vije në zbatim dispozita nga nenin 382 i LMD, i cili përcakton se: *“1. Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. 2. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë.”*

4. Vlerësimet e gjykatës

Pas analizimit dhe vlerësimit të gjendjes faktike të vërtetuar, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, për faktin se paditësi si pasojë e mungesës së automjetit të tij transportues “Mercedes” tipi 905 me targa ..., për 22 ditë pune ose një muaj kalendarik mesatar të vitit (komplet me vikende), paditësit i është shkaktuar dëm në lartësi prej

2,002.40€, siç është përcaktuar për numrin e ditëve të nevojshme për riparimin e automjetit transportues me ekspertizën e makinerisë të hartuar nga eksperti S.B. e datës 20.01.2020, dhe me ekspertizën financiare të hartuar nga eksperti financiar R.B. me datë 03.12.2018, me të cilat konstatohet se për kohën e nevojshme për riparimin e automjetit transportues “Mercedes” tipi 905, paditësi ka pësuar dëm në formën e fitimit të humbur shumë e aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata ia falë besimin ekspertizës së makinerisë e cila përcakton koha e arsyeshme për riparimin e automjetit të paditësit ishte 22 ditë pune ose një muaj mesatar i vitit (komplet me vikende), si dhe ekspertizës financiare sipas të cilët përcaktohet lartësia e kërkesëpadisë, dhe atë se fitimi i humbur, gjatë kohës sa automjeti kishte qenë në servisim respektivisht 22 ditë pune apo një muaj është 2,002.40€.

Andaj, gjykata bazuar në provat e administruara gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar sa i përket shumës në lartësi prej 2,002.40€, për 22 ditë pune apo një muaj kalendarik.

Gjykata deri tek ky konstatim erdhi për faktin se automjeti i dëmtuar ka qenë në pronësi të paditësit, i cili është përdorur për nevoja të afarizmit të biznesit dhe si aset i domosdoshëm për funksionimin e aktivitetit biznesor andaj në mungesë të automjetit të dëmtuar, paditësi gjatë kohës së riparimit e ka pasur të pamundur që të ushtrij veprimtarinë e tij afariste të transportimit të mallrave.

Gjykata refuzoi kërkesëpadinë e paditësit përtej shumës së gjykuar në dispozitivin I të këtij Aktgjykimi, pasi që nga provat e administruara gjykata gjeti se servisimi i automjetit ka zgjatur nga data 02.04.2015 deri me datën 20.01.2016, mirëpo sipas ekspertizës së makinerisë, koha e arsyeshme për riparimin e dëmit të shkaktuar nga aksidenti ka qenë 22 ditë apo përafërsisht një muaj.

Gjykata bazuar në vërtetimin mbi servisimin e kamionit të datës 18.10.2018, gjeti se paditësi nuk kishte pasur në shfrytëzim automjetin e tij nga data 02.04.2015 deri me datën 20.01.2016, si pasojë e vonësës së pagesës së servisimit, mirëpo gjykata me asnjë provë nuk arriti të vërtetoj paaftësinë paguese të paditësit, për përmbushjen e detyrimit ndaj kompanisë së servisimit, në mënyrë që të marr në përdorim automjetin e tij dhe të vazhdoj në mënyrë të rregullt ushtrimin e veprimtarisë së tij transportuese – afariste dhe se gjykata nuk mundi të vërtetoj në tërësi këtë pretendim të paditësit pasi që automjeti transportues ishte lëshuar nga servisi me datë 20.01.2016 ndërsa pagesa nga i padituri për dëmin material sipas ujdisë së arritur ishte bërë me datë

25.02.2016 ashtu që ka rezultuar se vonesa në rregullimin e automjetit transportues nuk ka qenë e ndërlidhur me pagesën nga i padituri për dëmin material.

Po ashtu, sipas vlerësimit të gjykatës, nga Certifikata e biznesit me nr. 80039905, informatat e biznesit dhe licencës së lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës, rezulton se paditësi si veprimtari themelore ka transportimin përmes automjeteve transportuesese dhe nga dokumentacioni doganor rezulton se paditësi ka pasur në shfrytëzim edhe automjete të tjera, përmes të cilave ka kryer shërbimet e transportit, që nënkupton se mungesa e automjetit në fjalë nuk e ka pezulluar gjithë aktivitetin afarist të paditësit, pasi që paditësi ka mundur të vazhdoj ushtrimin e veprimtarisë së tij përmes automjeteve të tjera që ka pasur në dispozicion.

Në këtë drejtim, gjykata vlerësoi se paditësi nuk ka arritur të vërtetoj se automjeti i aksidentuar ka qenë mjete i vetëm transportues i paditësit dhe se më mungesën e të cilit është ndërprerë në tërësi aktiviteti i tij afarist, si dhe nuk ka arritur të vërtetoj se si pasojë e pa aftësisë së tij paguese nuk ka mundur të realizoj pagesën e servisimit dhe të marr në shfrytëzim automjetin e aksidentuar menjëherë pas servisimit, e që sipas ekspertizës koha e arsyeshme e sanimit të dëmit të shkaktuar si pasojë e aksidentit ka qenë 1 muaj kalendarik apo 22 ditë pune.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e të paditurit se sipas Ujdisë Jashtëgjyqësore paditësi ka humbur të drejtën përkatësisht ka hequr dorë vet për të kërkuar kompensim shtesë të dëmi material edhe po që se paraqiten pasoja të tjera, por që gjykata këto pretendimet i vlerësoi si të pabazuara për faktin se edhe vetë i padituri kërkesën e paditësit për fitim të humbur si pasojë e mos shfrytëzimit të automjetit transportues e ka trajtuar në mënyrë të ndarë nga dëmi material që ka pësuar në aksident e të cilat janë kompensuar sipas Ujdisë jashtëgjyqësore të datës 29.12.2015 dhe se neni IV i ujdisë përcakton se *“Shuma e caktuar e zhdëmtimit-objekt i kësaj Ujdie jashtëgjyqësore përmban zhdëmtimin për dëmin material – në automjet dhe i dëmtuari nuk ka të drejtë të kërkoj zhdëmtim shtesë poqëse paraqiten pasoja të tjera, pos atyre të cilat janë përfshirë në këtë Ujdi”* ashtu që gjykata vlerëson se vetë kjo dispozitë përcakton zhdëmtimin për dëmin material në automjet, ndërsa kërkesa për fitim të humbur ka të bëjë me kërkesë të shoqërisë tregtare në këtë rast paditësit, pra në këtë rast nuk ka qenë qëllimi që me ujdinë jashtëgjyqësore të përfshihet edhe dëmi material në formën e fitimit të humbur. Prandaj, gjykata vlerësoi se paditësi nga nënshkrimi i ujdisë jashtëgjyqësore nuk ka hequr dorë nga kërkesa për dëmin material në formën e fitimit të humbur që e ka pësuar i njëjti për periudhën e pamundësisë së përdorimit të automjetit “Mercedes” tipi 905 me tabela ..., për 22 ditë pune.

Andaj, nga konstatimet e mësipërme, gjykata përfundimisht vlerëson se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, andaj të njëjtën e aprovoi sa i përket shumës si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe e refuzoi përtej kësaj shume përkatësisht si në pikën II të dispozitivit të këtij Aktgjykimi.

5. *Shpenzimet e procedurës*

Lidhur me shpenzimet gjyqësore si në pikën III të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, gjykata vendosi sipas nenit 452 par.1 dhe 2 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e arritur në procedurën gjyqësore, ashtu që paditësit ia njohu shpenzimet e procedurës dhe atë, për padi shumë prej 156.00€, për taksë gjyqësore shumë prej 15.00€, për ekspertizë financiare dhe shumë prej 150.00€, për ekspertizë të makinerisë shumë prej 200.00€, për plotësim të ekspertizës financiare shumë prej 150.00€, për tri seanca në Gjykatën Themelore në Prishtinë –Departamenti për Çështje Ekonomike dhe tri seanca pranë kësaj gjykate nga 135.20€ për seancë apo shumë e përgjithshme prej 1,482.20€, sipas tarifës së OAK-së për kontestet mbi vlerën e vogël e deri në 10,000€.

Gjykata duke iu referuar nenit 382 të LMD-së, me të cilin përcaktohet se: “*Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën*”, e miratoi kamatëvonesën e kërkuar, ashtu që e detyroi të paditurin që përveç shumës në emër të kompensimit, paditësit t’ia paguajë edhe kamatën ligjore prej 8 % në vit, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë 23.03.2016 e deri në pagesën definitive.

Nga të cekurat më lartë, gjykata bazuar në nenin 143 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.113/22, datë 24.05.2024

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të Aktgjykimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.